




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH. Nr. 299/17

PANELI SHQYRTUES, i emëruar në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, si dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin nr.04/L-237, me ligjin nr.05/L-068 dhe me ligjin 05/L-92, në përbërje prej z.Nuhi Paçarizi - Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Pastor Kosova” shpk nga Prishtina, kundër autoritetit kontraktues / Agjencioni Pyjor i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kanistera (çanta shpinore për fikjen e zjarrit”, me nr. të Prokurimit: 40300/17/004/136, më datën 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet**, ankesa e operatorit ekonomik: “Pastor Kosova” shpk nga Prishtina, me nr. 299/17, parashtruar kundër autoritetit kontraktues/ Agjencioni Pyjor i Kosovës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kanistera (çanta shpinore për fikjen e zjarrit”, me nr. të Prokurimit: 40300/17/004/136, si e bazuar pjesërisht.
- II. **Anulohet**, vendimi i Autoritetit Kontraktues/ Agjencioni Pyjor i Kosovës, njoftimi për dhënie të kontratës, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kanistera (çanta shpinore për fikjen e zjarrit”, me nr. të Prokurimit: 40300/17/004/136, si i pa bazuar.
- III. **Obligohet**, Autoritetit Kontraktues / Agjencioni Pyjor i Kosovës, që aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me kanistera (çanta shpinore për fikjen e zjarrit”, me nr. të Prokurimit: 40300/17/004/136, t’a kthej në ri vlerësim.
- IV. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë prokurim. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin Shqyrtues që konform dispozitive

ligjore të nenit 131 të LPP-së nr. 04/L-042, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues, që nuk respekton vendimin e Panelit Shqyrtues të paraparë me këtë ligj.

- V. Operatorit ekonomik ankues **“Pastor Kosova”shpk**, i kthehet tarifa e sigurimit të ankesës, megjithatë obligohet i njëjti që në afat prej më së largu gjashtëdhjetë (60) ditësh të paraqes kërkesë për kthim të mjeteve - sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe mjetet kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik: **“Pastor Kosova”shpk**, me seli në Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP me dt: **25.08.2017**, me Nr. **229/17**, kundër rekomandimit për dhënje të kontratës, duke pretenduar se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat e LPP-së ne fuqi, siç janë:

- Neni – 7, 28, 29, 59, 60 dhe 69.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, pas pranimit të ankesës, në bazë të nenit 113 të LPP-së ne fuqi, ka autorizuar ekspertet e OSHP se, për të shqyrtuar pretendimet ankimore të përfshira në ankesën e **“Pastor Kosova”shpk**, – Prishtinë. Te njëjtit në raportin e datës: 14.09.2017, kanë sqaruar – trajtuar pretendimet e përfshira në ankesë, rrjedhimisht i kanë propozuar panelit shqyrtues që ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri vlerësim, ndërsa ankesa të aprovohet si e bazuar.

OE / **Pastor Kosova”shpk**, përmes parashtresës me shkrim të datës 19.09.2017 njofton panelin shqyrtues se të njëjtit pajtohen me mendimin e eksperteve të OSHP-së.

AK / Agjencioni Pyjor i Kosovës, po ashtu përmes parashtresës me shkrim të datës 18.09.2017, njofton panelin shqyrtues se të njëjtit nuk pajtohen me mendimin e eksperteve të OSHP-së.

Gjatë seancës së shqyrtimit kryesor të datës: **28.09.2017**, në të cilën ishin prezent kryetari i Panelit shqyrtues, eksperti teknik, perfagesuesi i parashtruesit të ankeses, u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit, i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi mbi dhënjen e kontrates, ankesa e operatorit ekonomik si dhe raporti i ekspertëve të OSHP-së.

Kryetari i panelit fillimisht fjalën ia dha përfaqësuesit të OE ankues z.Imeri i cili deklaroj: “Pretendimi kryesor ankimorë ka qenë për specifika teknike të caktuara nga AK në dosje të tenderit. Kundër kriterit për dhënie të kontratë pika 2.4 specifikat e detyrueshme teknike thotë se furnizimet duhet të jenë plotësisht me specifikat teknike në dosje të tenderit. Ne kemi vlerësuar se OE i rekomanduar nuk i plotëson këto kërkesa. Ne kemi pas ankesë të koha zbrajes së cantës, është kërkuar 5.3min, ndërsa OE fitues e ka dhënë 5 minuta. Arsyetimi tyre është se është më mirë të zbrazet më shpejt, mirëpo nga përvoja mendoj se kjo është gabim dhe se zgjatja qantes është më mirë të zgjas më shumë. Pasi duhet të ëshkohet me kilometra për mbushje të ujit andaj koha zbrajes është me rëndësi të jetë sa më e gjatë.

Pikë me rëndësi mendojmë se është zona veprimit që është kërkuar prej +6 deri në 75 gradë celsius, ndërsa OE fitues e ka dhënë prej +5 deri 60 gradë celsius. Kjo vetvetiur kupton se është qantë me material më të ëhollë, është ekëkruar me peshë 2kg, ndërsa OE fitues e ka dhënë me 1.5mkg, edhe pse materiali njëjtë por do thotë më pak material më i hollë andaj edhe rezistenca në temperaturë është më e vogël. Ne kemi pranuar edhe jemi pajtuar me raportin e ekspertizës së ekspertëve”.

Në vazhdim të seancës eksperti teknik z.Haxholli i cili deklaroj: “Lidhur me ankesën e OE ankues kemi shqyrtuar me vëmendje gjithë materialin që na është dorëzuar dhe gjatë shqyrtimit kemi gjetur këto të dhëna që kemi dhënë si sqarim duke marr për bazë që Agjencia Pyjore Kososvës ka dhënë disa specifika në të cilat nuk kanë dhënë minimum dhe maksimum por ka dhënë disa vlera të përcaktuara sakt. Përveq zonës së veprimit e cila në fillim ka qenë nga -10 deri 75 gradë celcius , ndërsa gjatë shqyrtimit të materialit kemi gjetur në sqarimin e kthyer nga znj.Kyreziu ku ka lejuar-ripërcaktuar zonën e veprimit nga +6 deri 75 gradë celcius nga arsyetimet që janë dhënë më herët. Gjatë shqyrtimit kemi pa se OE i rekomanduar për kontratë nuk i jka specifikat ekuivalente me specifikat e përcaktuara nga APK që ndryshojnë në tri pozicione. Koha e zbrajes së vrushkullit shpërndatës nga koha përcaktuar 5.3 minuta, ka dhënë opcionin 5 minuta.

E dytë pesha strajcës nga pesha kërkuar 2 kg në dhënë në 1.5 dhe koha veprimit nga +6 deri 75 e kërkuar OE e ka dhënë +5 deri 60. Nga kjo shihet se ndryshon nga specifikat teknike të detyrueshme oferta e OE të rekomanduar për kontratë. Po ashtu një sqarim i dytë ku nga kërkesat e OE-ve të interesuar ndaj APK-së ku janë bërë tri kërkesa me shkrim dhe janë kthyer përgjigjet nga znj. Kryeziu. Te pyetja dytë me rëndësi specifikat e kërkuara në përgjigjen e kthyer deklaroi se duhet të mbesin të njëjta, përveq zonës së veprimit e cila ripërcaktohet nga +6 deri 75, e që më herët ishte -10 deri 75. Dhe kanë deklaruar se nuk lejohen lloje tjera të shpinorëve të ofruara në tender. Kjo do thotë paraprakisht e përcakton se fituesi i tenderit duhet të ishte OE që ofron specifikat në bazë të specifikave teknike të detyrueshme. Te liferimi është ekëkruar nga 1- ditë të bëhet 20, mirëpo arsyetimi ka qenë që

për shkak gjendjes në veç nuk e kanë lejuar më shumë se 10 ditë. Sipas kësaj kemi rekomanduar që të ruivlerësohet”.

Në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i OE z.Imeri deklaroj: ”Ipropozojmë panelit shqyrtues që të aprovoj ankesën tonë si të bazuar dhe lënda të kthehet në rivlerësim”.

Paneli shqyrtues duke u bazuar në provat shkresore si dhe sqarimet e dhena nga eksperti teknik konstatoj se komisioni i vlerësimit të ofertave ka rekomanduar për dhënje të kontrates operatorin ekonomik i cili nuk i ploteson në tërësi specifikacionet teknike të detyrueshme siq janë kërkuar nga AK, gjegjesisht të dhënat e përshkruara në katalogun e prezantuar nga operatori ekonomik i rekomanduar për dhenje të kontrates rezulton që nuk korespondojnë me të dhënat e percaktuara tek specifikacioneve teknike të detyrueshme të në dosje të tenderit dhe atyre të ndryshuara nga autoriteti kontraktues /Agjencioni Pyjor i Kosovës.

KRYETARI I PANELIT SHQYRTUES



Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur nuk mundë të ushtron ankesë, për kompensim dëmi në afat prej 30 ditësh, pas pranimit të këtij vendimi, mund të ngritë kërkesëpadi në Departamentin për çështje administrativ pranë Gjykatës Themelore.

Vendimi t'i dorëzohet:

1. AK / Agjencioni Pyjor i Kosovës;
2. OE / Pastor Kosova”shpk – Prishtinë
3. Arhivës së OSHP-së.